



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hyrje në Teorinë e Komunikimit

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë me përzgjedhje

Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: markeliana.anastasi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo është një lëndë me zgjedhje dhe me karakter hyrës dhe të përgjithshëm, që do t'i japë studentit një perspektivë mbi teorinë kryesore të komunikimit, këndvështrimet e ndryshme nga të cilat analizohet komunikimi, historinë e mediave dhe zhvillimin e tyre në periudhën dixhitale; historinë e komunikimit, që nga fillimet e tij e deri në ditët e sotme, analizën e dokumentave, komunikimin ndërkulturor. Aftësinë për të zhvilluar kompetencën e arësytimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve dhe projekteve përgjatë kursit; Aftësinë për të ushtruar një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e faktorëve të ndryshëm që mundësojnë komunikimin.; Aftësinë për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushën e komunikimit. etj. Nga ana tjetër, nëpërmjet temës në fund të semestrit, synon të zhvillojë te studenti mendimin e pavarur individual për komunikimin, specialitetet, teknikat dhe sfidat e tij

Objektivat specifike lëndore:

1. Të jetë i aftë të identifikojë dhe veçojë konceptet dhe format themelore të strukturave të komunikimit; të analizojë pjesët përbërëse të tij; të kategorizojë nivelet e komunikimit ;
2. Të jetë i aftë të dallojë konceptet themelore të analizës së dokumentave;
3. Të jetë i aftë të identifikojë dhe të veçojë të gjitha format themelore të komunikimit; të realizojë një punim duke u nisur nga elementë të përgjithshëm për të arritur tek detaji që duam të analizojmë.

Rezultatet e pritshme:

1. Të jetë i aftë për të komunikuar me gojë dhe me shkrim si dhe njohja e terminologjisë bazë të komunikimit;
2. Të jetë i aftë për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet
3. Të jetë i aftë për nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për temat sociale. Kompromisi me etikën si dhe me përgjegjësinë qytetare e profesionale.
4. Të jetë aftës për të njohur proceset e komunikimit të plurikulturalizmit, ndërkulturalizmit dhe diversitetit kulturor.